

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Sot me datën 05.04 2021 (dymijë e njëzete e një), në Tiranë, lidhet kjo Kontratë Shitblerje Kuote (në vijim referuar si "Kontrata"), ndërmjet palëve si vijon:

SHITËSI: **ALB-STAR**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me Numër Unik Identifikimi të Subjektit ("NUIS") J62903512W, dhe seli në adresën *Fier, Patos, Zona Industriale Patos, nr.pasurie 69/29, zona kadastrale nr.2890*, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori Z. Edmond Spahiu,

(në vijim referuar si "Shitësi")

BLERESI: **GJOKA KONSTRUKSION**, shoqëri aksionare, regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me Numër Unik Identifikimi të Subjektit ("NUIS") J91815014U, dhe seli në adresën *Rruga: Dora D'Istria, Hyrja nr. 6, Tirane*, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori Z. Rrok Gjoka.

(në vijim referuar si "Blerësi")

Këtu e në vijim Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si "Palë" dhe së bashku si "Palët".

MEQENËSE:

1. Shoqëria "GRABOVA HYDROPOWER" sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit, regjistruar në regjistrin tregtar, të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS): L72122043D, me seli në adresën: *Rruga Sami Frasheri, Ndërtesa Nr. 19, Hyrja Nr. 8* (në vijim referuar si "Shoqëria")
2. Bazuar në Ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë i ndarë si vijon:
 - a. Shoqëria "AGNA", zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 33.000,00 (tridhjetë e tre mijë) Lekë, që i korrespondojnë 33,00 (tridhjetë e tre) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - b. Shoqëria "GR ALBANIA", zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 33.000,00 (tridhjetë e tre mijë) Lekë, që i korrespondojnë 33,00 (tridhjetë e tre) % të kapitalit të Shoqërisë
 - c. Shoqëria "ALB-STAR", zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 34.000,00 (tridhjetë e katër mijë) Lekë, që i korrespondojnë 34,00 (tridhjetë e katër) % të kapitalit të Shoqërisë.



3. Shitësi siç përshkruhet edhe me sipër, është ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 34.000,00 (tridhjetë e katër mijë) Lekë, qe i korrespondojnë 34,00 (tridhjetë e katër) % të kapitalit të saj.
4. Shitësi, Shoqëria "AGNA", Shoqëria "GR ALBANIA", ne cilësinë e Huadhënësve, kane lidhur Kontratën e Huasë datë 10.09.2018, me Shoqërinë "GRABOVA HYDROPOWER" sh.p.k, ne cilësinë e Huamarrësit, me qellim financimin e Shoqërisë për zhvillimin e aktivitetit te saj.
5. Shitësi, dhe njëherazi Ortaku i Shoqërisë, dëshiron të tjetërsojë kuotën qe ai zotëron në Shoqërinë, nëpërmjet shitjes tek Blerësi, përkundrejt çmimit të shitjes.
6. Blerësi nga ana tjetër dëshiron të blejë kuotën qe Shitësi zotëron tek Shoqëria duke paguar çmimin e shitjes.

PËR KËTË ARSYE, në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Transferimi me anë të shitblerjes, të 1 (një) kuote qe Shitësi zotëron në Shoqërinë "GRABOVA HYDROPOWER" shpk, me vlere nominale 34.000,00 (tridhjetë e katër mijë) Lekë, qe i korrespondojnë 34,00 (tridhjetë e katër) % të kapitalit të Saj.

NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E LIKUIDIMIT

- 2.1 Me vullnet të përbashkët të palëve caktohet se çmimi i shitjes së kuotës se përshkruara ne nenin 1 të kësaj Kontrate të jetë 34.000,00 (tridhjetë e katër mijë) Lekë.
- 2.2 Çmimi i shitjes do të paguhet në llogarinë bankare të deklaruar nga Shitësi me të dhënat vijuese:

<i>Emri i Bankës:</i>	OTP Bank Albania Sha
<i>Numri i llogarisë:</i>	00000898168
<i>IBAN:</i>	AL77213110440000000000898168
<i>Përfituesi:</i>	ALB-STAR Shpk
- 2.3 Çmimi i Shitjes do te likuidohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Megjithatë Çmimi i Shitjes duhet likuiduar deri ne 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit te saj.



NENI 3
DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESIT

Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

(a) Pronar i Ligjshëm

Shitësi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i kuotës se zotëruar prej tij në Shoqëri identifikuar në dokumentet bashkëngjitur dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontratë, dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj.

(b) Barrët mbi Pronën

Shitësi deklaron, kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri, objekt i kësaj Kontrate nuk është e ngarkuar me asnjë barrë, qoftë si peng, barrë siguroese apo barrë financiare (qofshin këto ligjore, gjyqësore apo kontraktore), apo të drejta të tjera të ngjashme me to, çdo e drejtë apo interes i dhënë me kontratë çdo personi, duke përfshirë çdo të drejtë blerje, opsioni ose të drejtë parablerje, dhënie përdorimi apo posedimi me kontratë të tjera, si dhe pa u kufizuar në to, çdo transaksion, veprim juridik a kufizim ligjor tjetër, përfshi këtu çdo vendim gjyqësor, përfundimtar apo të ndërmjetëm, vendim përbarimor, apo të autoriteteve të tjera përcaktuar me ligj, i tillë që do të cenonte titullin e pronësisë së Blerësit mbi kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate.

(c) Garancia

Në bazë të njohurive më të mira të Shitësit, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ekzistojnë pretendime nga të tretët, çështje gjyqësore në gjykim, të pezulluara ose të mundshme, pretendime ose vendime gjyqësore a masa sigurimi në lidhje me kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate dhe asnjëra prej këtyre padive, proceseve gjyqësore, masave dhe pretendimeve nuk ka të ngjarë të ndodhë; Të gjitha deklaratimet dhe garancitë e Shitësit të paraqitura me sipër janë të vërteta dhe të sakta.

NENI 4
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1 Detyrimet e Shitësit

(a) Nënshkrimi i Akteve

Shitësi merr përsipër dhe detyrohet të nënshkruajë çdo akt e të kryejë çdo veprim juridik pa vonesa, kur i kërkohet nga Blerësi, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, e që mungesa e të cilit do të pengonte ushtrimin e plote, të pakushtëzuar e të pakufizuar prej Blerësit të së drejtës së tij të pronësisë mbi këtë kuotë.

(b) Mbrojtja Gjyqësore

Në rastin kur një palë e trete (përfshi autoritetet publike) ngre pretendime dhe/ose bënë ankim gjyqësor për të kundërshtuar titullin e pronësisë të Blerësit mbi kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, ose duke u bazuar në pretendime të mëparshme cenon apo kundërshton të drejtat që burojnë nga kjo kuotë, Shitësi merr përsipër dhe detyrohet të thirret/ndërhyje në gjykimin e çështjes, dhe me shpenzimet e tij të mbroje interesat e Blerësit si të ishin të tijat.

(c) Cenimi i Titullit

Pa kufizuar të drejtat e tjera të Blerësit të përcaktuar me ligj, Shitësi merr përsipër dhe detyrohet të mbrojë, zhdëmtojë, dëmshpërblejë, dhe ruajë Blerësin, ndaj dhe në vlerën e plotë të: (i) çdo detyrimi, dëmi, humbjeje, apo shpenzimi, përfshi këtu shpenzimet e avokatit apo të ekspertëve të Shitësit që rezultojnë nga dokumente zyrtare (kontrata, fatura), të pasur nga Blerësi për t'u mbrojtur nga çdo pretendim, kërkesë, apo padie, proces a vendim gjyqësor, përmbarimor të një të treti (*për qëllimet e këtij neni, i tretë quhen edhe autoritetet publike kur veprojnë në rastet e parashikuara me ligj*) që duke u hequr si pronar i ligjshëm, kundërshton titullin e pronësisë të Blerësit mbi kuotën objekt transferim sipas kësaj Kontrate.

4.2 Detyrimet e Blerësit

(a) Likuidimi i Çmimit të Shitjes

Pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër të Shitësit, siç parashikohet me ligj dhe me këtë Kontratë, Blerësi merr përsipër dhe është i detyruar të paguajë Çmimin e kësaj Kontrate brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj.

NENI 5

FORCAT MADHORE

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të mbajë përgjegjësi kundrejt tjetrës për mos përmbushje, pjesërisht ose tërësisht, të detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate kur kryerja e tyre vonohet, pengohet ose ndalohet në rast të ndonjë Force Madhore;
- 5.2 Për qëllime të kësaj Kontrate, me "**Forcë Madhore**" do të kuptohet një ngjarje apo ndodhi përtej kontrollit të arsyeshëm të Palëve, e paparashikueshme, e pashmangshme, dhe që e bën të pamundur realizimin e detyrimeve të Palëve sipas kësaj Kontrate dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet e pamundur në rrethanat e ndodhura.
- 5.3 Ngjarje të Forcës Madhore do të konsiderohen por pa u kufizuar në to:
- luftëra, të shpallur ose jo, luftëra civile, trazirat dhe revolucione, epidemi, akte sabotimi dhe/ose terrorizmi,
 - tërmete, zjarre, shpërthime, stuhi, përmytje ose kushte të tjera atmosferike të jashtëzakonshme,

- c. bojkotet dhe/ose greva e çdo zaptimet e fabrikave dhe ambienteve, ndalimet e paligjshme të punimeve të cilat ndodhin në ambientet e Palës mospermbushese.
 - d. akte të autoriteteve, të ligjshme ose jo, përveç akteve për të cilat Pala mospermbushese, ka marrë përsipër rrezikun në bazë të dispozitave të kësaj Kontrate.
- 5.4 Çdo Palë që pjesërisht ose plotësisht nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet sipas kësaj Kontrate, duhet t'i paraqesë një njoftim me shkrim palës tjetër lidhur me këtë fakt, duke dhënë me hollësi rrethanat e kësaj Force Madhore;
- 5.5 Çdo Palë që pretendon se përmbushja e detyrimeve të saj pengohet nga një ngjarje e Forcës Madhore duhet t'i bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për ta larguar këtë Forcë Madhore dhe do t'i paraqesë menjëherë me shkrim Palës tjetër për përfundimin ose mbarimin e shkakat të Forcës Madhore. Kjo Palë do t'i vazhdojë detyrimet e lëna pezull sa më parë të jetë e mundur pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore.

NENI 6

TË NDRYSHME

6.1 Interpretimi

Përveç se kur konteksti i kësaj Kontrate kërkon ndryshe:

(i) fjalët e secilës gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

(ii) termat "*të kësaj*", "*këtu*", "*nëpërmjet kësaj ose nga kjo*", "*në këtë*" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Bashkëlidhje apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;

(iii) Parashtrimet, Shtojcat, dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të saj dhe referencat në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët merren vesh ndryshe.

(iv) referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrjeje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referenca në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar, rinxjerrë apo ribërë;

(v) fjalët "*përfshin*" ose "*duke përfshirë*" do të konsiderohet se pasohen nga "*pa kufizim*" ose "*duke mos u kufizuar në*", edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;

(vi) referencat në "*kjo kontratë*" ose në çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë kontratë ose dokument, të ndryshuar, modifikuar, ose shtuar dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë dokument, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

(vii) sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "*ditësh*" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur shprehimisht specifikohen si Ditë Pune;

(viii) titujt e Neneve, Kapitujt dhe Nenet në këtë Kontratë janë bërë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference, dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrate

6.2 Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë Parashtrimet dhe Shtojcat bashkëngjitur saj, përbën tërësinë e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, dhe zëvendëson çdo ose të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të kryhet me shkrim dhe të miratohet nga palët përndryshe do të konsiderohet e pavlefshme.

6.3 Vecueshmeria e Kontratës

Nëse ndonjë kusht apo dispozite e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme dhe/ose e paligjshme dhe/ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Palët në mirëkuptim do të mundohen të zëvendësojnë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

6.4 Njoftimet

a Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate do të:

(i) bëhet në gjuhen shqipe;

(ii) behet me shkrim;

(iii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me poste te shpejte në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, dhe

(iv) shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të person(ave) të tjerë të tillë që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.

b Për efekt njoftimi sipas klauzolës së mësipërme (a) të këtij neni, palët deklarojnë adresat e poshtëshënuara:

Për Shitësin: ALB-STAR Shpk

Në vëmendje të: Z. Edmond SPAHIU

Adresa: Rruga Blv. 'Deshmoret e Kombit', Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati 5, Tirane

Telefon: 0035542280121

E-mail: e.spahiu@albstar.al

Për Blerësin: Gjoka Konstruksion sh.a

Në vëmendje të: Z.Rrok Gjoka

Adresa: Rruga "Dora D'Istria", Hyrja Nr. 6, Tirane

Telefon: 0035542274809

E-mail: info@gjoka.al

- c Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tjetra, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë në adresën e mëposhtme të palës tjetër (siç mund të ndryshohet herë pas herë me njoftimin e arsyeshëm të kryer nga secila Palë te Pala tjetër), nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejte dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç është parashikuar më sipër, në adresat e deklaruara prej palëve.

NENI 7

EFEKTE LIGJORE

- 7.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe likuidimin e çmimit të blerjes, Blerësi bëhet pronar me të drejta të plota të kuotës së blerë, sipas përcaktimit të Objektivit të kësaj Kontrate, si më sipër, dhe Shitësi zhvishet nga çdo e drejtë lidhur me këtë kuotë.
- 7.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:
- ALB-STAR, do pushojë se qeni ortak i Shoqërisë.
 - Shoqëria "AGNA", mbetet zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 33.000,00 (tridhjetë e tre mijë) Lekë, që i korrespondojnë 33,00 (tridhjetë e tre) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - Shoqëria "GR ALBANIA", mbetet zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 33.000,00 (tridhjetë e tre mijë) Lekë, që i korrespondojnë 33,00 (tridhjetë e tre) % të kapitalit të Shoqërisë
 - Shoqëria "GJOKA KONSTRUKSION" sh.a, do të behet zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 34.000,00 (tridhjetë e katër mijë) Lekë, që i korrespondojnë 34,00 (tridhjetë e katër) % të kapitalit të Shoqërisë.
- 7.3 Blerësi merr përsipër, që do të kryejë të gjitha veprimet përkatëse për të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") këtë Kontrate dhe ndryshimet përkatëse në kuotat e Shoqërisë sipas pikës 2 të këtij Neni të Kontratës.
- 7.4 Shitësi do të kalojë Kredinë e tij të gjeneruar nga Kontrata e Huasë date 10.09.2018, Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Blerësi merr përsipër që t'i japë Hua Shoqërisë në vlerën e përcaktuar në Kontratën e Huasë date 10.09.2018. Shoqëria me kalimin e shumës së Huasë në llogarinë e saj do t'i kthejë menjëherë Shitësit shume të financuar prej tij. Pavarësisht kësaj dispozite,

Palët e cituara ne këtë pike 7.4 do te nënshkruajnë një Kontratë Kalimi Kredie ne te cilën do te përcaktohen me ne detaje teknikalitetet e Kalimit te Kredisë.

NENI 8

LIGJI I ZBATUESHEM

- 8.1 Kjo Kontrate hartohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe vlefshmëria dhe realizimi i saj do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 8.2 Për sa nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur në këtë Kontrate, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Shqiptar.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 9.1 Nëse midis palëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e mosmarrëveshjes. Pas njoftimit Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 9.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me sa më sipër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo Mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Kjo kontratë është përgatitur në Shqip, në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Kjo Kontratë hyn në fuqi ne datën e nënshkrimit te saj nga palët.

Palët pasi lexuan Kontratën bien dakord me sa është përcaktuar më sipër dhe konfirmojnë se ajo është përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar.

SHITËSI

Për Shoqërinë **ALB-STAR** sh.p.k.



BLERËSI

Për Shoqërinë **Gjoka Konstruksion** sh.a

